



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 janar 2018
Nr. ref.: RK 1184/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI65/17

Parashtrues

Ilir Beqiri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
të 8 majit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ilir Beqiri nga Ferizaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Vahide Braha, avokate në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Njoftimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), të 8 majit 2017, në lidhje me Aktvendimin GJA. nr. 155/17, të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të 11 prillit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së njoftimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me paragrafin 2, të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) *“të sjellë masën e përkohshme si çështje paraprake dhe të pezullojë fillimin e shqyrtimit të gjykimit me të njëjtin Panel (...)”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 54 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 qershor 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata Kushtetuese).
7. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 26 korrik 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të sqarojë disa aspekte të kërkesës së tij. Po të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës Themelore në Ferizaj.
9. Më 7 gusht 2017, parashtruesi e njoftoi Gjykatën se Gjykata Themelore në Ferizaj ka pezulluar gjykimin e parashtruesit derisa të merret një vendim nga Gjykata në lidhje me kërkesën e tij.
10. Më 4 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 6 prill 2015, Gjykata Themelore në Ferizaj (Aktgjykimi PKR-690/12) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi atë me burgim. Gjykata Themelore gjithashtu urdhëroi parashtruesin që t'ia paguajë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave një shumë të caktuar.
12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën e Apelit ankesë kundër atij aktgjykimi, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
13. Më 19 tetor 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR nr. 384/2015) e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim, sepse aktgjykimi ishte i paqartë dhe i pakuptueshëm në lidhje me faktet vendimtare të rastit dhe nuk arriti të japë një shpjegim se si parashtruesi i kërkesës keqpërdori pozitën zyrtare.
14. Më 26 qershor 2016, Gjykata Themelore (Aktgjykimi PKR nr. 191/15), me të njëjtën përbërje të trupit gjykues, e shpalli parashtruesin fajtor për shkak se nuk kishte vepruar në pajtim me nenin 22 (3) të Ligjit për Prokurim Publik.
15. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për herë të dytë dhe për të njëjtat arsye, si në ankesën e tij të parë.
16. Më 4 tetor 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi 478/2016) aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, anuloi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore dhe e ktheu rastin për herë të dytë për rishqyrtim, për shkak të arsyeve si në vendimin e saj të parë të ankesës.
17. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2017, parashtruesi, në pajtim me nenin 39 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), kërkoi nga Kryetari i Gjykatës Themelore që ta përjashtojë trupin gjykues, i cili tashmë e kishte gjykuar rastin e tij dy herë. Parashtruesi i kërkesës pohoi dyshimet e tij duke shtuar se ai trup gjykues ka marrë një qëndrim të njëanshëm ndaj tij, ka zbatuar standarde të dyfishta dhe ka aplikuar drejtësinë selektive, duke refuzuar parashtruesat e tij.
18. Më 5 prill 2017, parashtruesi i kërkesës, duke u mbështetur në paragrafin 1, të nenit 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] i Kushtetutës, paraqiti pranë KGJK-së një kërkesë për caktimin e çështjes së tij në një gjykatë tjetër brenda Kosovës. Parashtruesi i kërkesës përsëriti dyshimet e tij rreth anshmërisë, standardeve të dyfishta dhe 'drejtësisë selektive' të trupit gjykues të Gjykatës Themelore.
19. Më 11 prill 2017, Kryetari i Gjykatës Themelore (Aktvendimi GJA. nr. 155/17) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për përjashtim të trupit gjykues, duke konsideruar që:

“... për pretendimet për njëanshmëri të trupit gjykues nuk ekziston ndonjë provë apo fakt që do të bënte të besueshëm një pretendim të tillë, por më

tepër mund të konsiderohen në nivel të perceptimeve dhe të pambështetura në ndonjë fakt apo provë”.

20. Më 8 maj 2017, KGJK (Njoftimi i 8 majit 2017) e njoftoi parashtruesin e kërkesës se, në bazë të nenit 42, pikat 1.1 dhe 3 të KPP-së, *“Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk është kompetent të delegojë lëndët nga një gjykatë në tjetrën e rrjedhimisht as të veprojë sipas kërkesës suaj”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Njoftimi i KGJK-së ka shkelur *“të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke injoruar faktet dhe provat e paraqitura”* dhe në lidhje me *“veprimet e njëanshme të panelit”*. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se KGJK-ja *“ka injoruar nenin 108 të Kushtetutës.”*
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Aktgjykimet e kësaj gjykate [Gjykata Themelore], dy herë radhazi janë abroguar nga ana e shkallës së Apelit të Kosovës, ndërsa të gjithë të akuzuarit tjerë janë liruar nga akuzat”.*
23. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Njoftimi i KGJK-së *“është i kundërligjshëm, pasi që nuk ka dhënë asnjë arsye ligjore se pse provat të cilat i paraqitëm respektivisht dëshmitë e ofruara siç ishin aktgjykimet një dhe dy të kësaj Gjykate të cilat janë haptas të anshme”.*
24. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata *“të bëjë interpretimin dhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 108”* të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
26. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113 (1 dhe 7) të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.

29. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se dispozitat e sipërpërmendura përcaktojnë *“shterimin e të gjitha mjeteve juridike”* si kriter vendimtar për pranueshmëri.
30. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’u ofrohet gjykatave të rregullta mundësia për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin e pasqyruar në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese rasti KI41/09 *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), rasti *Selmouni kundër Francës*, kërkesa nr. 25803/94, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 74).
31. Përveç kësaj, Gjykata thekson se parashtguesit janë të obliguar t’i shterojnë mjetet juridike që janë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, pra, mjetet që janë të qasshme, që sigurojnë kompensim lidhur me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses (shih rastin e GJEDNJ-së *Sejdović kundër Italisë*, Kërkesa nr. 56581/00, e 1 marsit 2006, paragrafi 46).
32. Gjykata vëren se kundër njoftimit të kontestuar të KGJK-së në lidhje me Aktvendimin (Gj. nr. 155/17, të 11 prillit 2017) e Kryetarit të Gjykatës Themelore, përkitazi me pretendimin e parashtguesit të kërkesës për mungesën e paanshmërisë së trupit gjykues nuk mund të parashtrohet ankesë.
33. Përveç kësaj, kërkesa e parashtguesit e paraqitur pranë KGJK-së për ndarjen e lëndës së tij në një gjykatë tjetër brenda Kosovës nuk ishte lejuar ligjërisht në bazë të nenit 42, pikat 1.1 dhe 3 të KPP, *“Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk është kompetent të delegoj lëndët nga një gjykatë në tjetrën”*.
34. Nga ana tjetër, kërkesa e parashtguesit drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore për të përjashtuar trupin gjykues, u refuzua si e pabazuar.
35. Gjykata gjithashtu rikujton se neni 42 (3) i KPP-së, parasheh se *“Kundër aktvendimit me të cilin pranohet kërkesa për përjashtim nuk lejohet ankesë”* dhe *“një aktvendim i tillë është marrë pas ngritjes së aktakuzës, atëherë mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit”*.
36. Gjykata konsideron se thelbi i pretendimit të parashtguesit të kërkesës mbështetet në *“veprimet e pjesshme”* të trupit gjykues të Gjykatës Themelore, pasi që aktgjykimet e saj *“dy herë radhazi janë shfuqizuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës”*.

37. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se procedurat janë duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore ku pritet që të merret aktgjykimi i tretë pasi çështja të jetë kthyer për herë të dytë. Pastaj lejohet aktvendimi lidhur me kërkesën për përjashtim dhe pretendimi i parashtruesit për mungesën e paanshmërisë së trupit gjykues.
38. Përveç kësaj, Gjykata vëren se neni 398 (2) i KPP-së, parasheh që *“Gjykata e Apelit mund të urdhërojë Gjykatën Themelore që të caktojë një tjetër, sipas një sistemi të caktimit të lëndëve që të jetë objektiv dhe transparent (...) trup gjykues nëse Gjykata e Apelit vlerëson se (...) trupi gjykues që e ka gjykuar rastin në mënyrë të vazhdueshme nuk e ka zbatuar ligjin siç duhet, ka vlerësuar shumë gabimisht provat ose moscaktimi (...) i trupit gjykues tjetër do të rezultonte në keqpërdorim të drejtësisë ose konflikt të interesit”*.
39. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata *“vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe interpretimin e nenit 108”* të Kushtetutës në lidhje me Njoftimin e KGJK-së.
40. Gjykata konsideron se një vlerësim dhe interpretim i tillë është pa objekt, pasi që kërkesa në KGJK nuk lejohet ligjërisht.
41. Prandaj, Gjykata konstaton se, lidhur me pretendimin e tij për mungesën e paanshmërisë së trupit gjykues, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar ende të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, të parapara me nenin 47.2 të Ligjit dhe të specifikuara me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

42. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoj nga Gjykata *“të bjerë masën e përkohshme si çështje paraprake dhe të pezulloj fillimin e shqyrtimit të gjykimit me të njëjtin Panel gjykues”*.
43. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, i cili thotë:
 1. *“Gjykata Kushtetuese sipas (...) mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme (...), nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik”*.
44. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:

 - (a) *pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
 - (...)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

45. Gjykata pasi ka konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës.
46. Prandaj, në pajtim me nenin 116.2 të Kushtetutës, në nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.


PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, në nenet 27. 1, 47. 2 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (b), 55 (4) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi